

	
ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësia: Unit:	Nr. Prot.: Prot. No.:
Unit: Jednina:	Br. Prot.: Br. Prot.:
Nr. i faqëve: No. of pages:	Data: Date:
Br. atyresis: Br. atyresis:	Returimi: Return:
	Prishtinë/Prishtina



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF 03/2020

**KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS**, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.12 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 22, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.12 dhe 1.14 dhe Nenit 53, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të OMK-së dhe Nenit 23, paragrafit 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 25 nëntor 2020, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

### PËR CAKTIMIN E KUOTËS SË ANËTARËSISË

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 01/2020 të Kuvendit të OMK-së, datë 25 nëntor 2020)

#### Neni 1

#### **Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët të cilët ushtrojnë veprimtarinë mjekësore në Republikën e Kosovës**

I. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët e punësuar në institucione publike dhe private, për mjekët e pensionuar që ushtrojnë veprimtarinë mjekësore si të punësuar, specializantët dhe mjekët nga Lugina e Preshevës, në shumë prej 80.00 (tetëdhjetë) € (euro);

II. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët e papunë nga kategoritë e cekura në paragrafin I (mjekët shtetas kosovarë, specializantë pa kontratë pune dhe mjekët e papunë na Lugina e Preshevës) në shumë prej 40.00 (katërdhjetë) € (euro);

III. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët e rinjë shtetas kosovar dhe mjekët e rinjë nga Lugina e Preshevës, të cilët kryejnë provimin e licencës për herë të parë gjatë vitit kalendarik

përkatës pas datës 1 korrik dhe anëtarësohen në OMK , në shumë prej 20.00 (njëzetë) € (euro);

IV.Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët me shtetësi kosovare të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë vendit dhe dëshirojnë vullnetarisht të regjistrohen dhe të anëtarësohen në Odë, në shumë prej 80.00 (tetëdhjetë) € (euro);

V.Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët me shtetësi të huaj në shumë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjet) € (euro);

VI.Lirohen nga detyrimi për të paguar kuotën e anëtarësisë vjetore në OMK, mjekët e pensionuar që nuk ushtrojnë veprimtarinë mjekësore, dhe të cilët e dëshmojnë përmes vërtetimit të ATK-së se nuk kanë deklaruar të hyra për vitin kalendarik kur bëhet pagesa e kuotës së anëtarësisë.

## **Neni 2**

### **Mënyra e ekzekutimit të pagesës së kuotës së anëtarësimi vjetor**

I. Mjeku i cili punon në institucionet shëndetësore publike do t'i bëhet ndalesa automatike e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore me pagën e muajit shkurt të vitit kalendarik përmes sistemit të pagave-Payroll, ose përmes sistemit të pagesave të OMK-së jo më larg se data 30 qershor e vitit kalendarik.

II. Mjeku i cili punon në institucionet shëndetësore private, mjeku i pensionuar që ushtron veprimtarinë mjekësore si i punësuar, specializanti dhe mjeku i punësuar nga Lugina e Preshevës obligohen që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjë jo më larg se data 30 qershor e vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .

III. Mjeku shtetas kosovarë, mjeku i pensionuar që nuk ushtron veprimtarinë mjekësore, specializanti pa kontratë pune dhe mjekët e papunë nga Lugina e Preshevës obligohen që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjë jo më larg se data 30 qershor e vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .

IV. Mjeku qytetar jo Kosovarë i cili ushtron veprimtarinë mjekësore në Republikën e Kosovës, obligohet që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjë jo më larg se data 30 qershor të vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .

V. Mjeku me shtetësi kosovare i cili ushtron veprimtarinë mjekësore jashtë territorit të Republikës së Kosovës e që vullnetarisht anëtarësohen në OMK, obligohet që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjnë jo më larg se data 30 qershor të vitit kalendarik përmes sistemit të pagesave të OMK-së .

### **Neni 3**

#### **Pasojat juridike për shkelje të obligimit të anëtarësimit**

I. Të gjithë mjekët që nuk i kryejnë obligimet sipas këtij Vendimi, lidhur me pagesën e kuotës së anëtarësisë, Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim i OMK-së, përmes Vendimit të formës së prerë do të ndërpres anëtarësimin në OMK sipas Nenit 15 paragrafi me nenparagrafin 1.4. të Statutit të OMK-së.

### **Neni 4**

#### **Hyrja në fuqi**

I. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative në OMK.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i OMK-së.

Prishtinë, 25 nëntor 2020

Kryetari i OMK-së  
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci

